

BASHKIA ELBASAN
NJOFTIM PËR BOTIM

Bashkia Elbasan në zbatim të V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", i ndryshuar dhe të V.K.B Nr. 97 datë 19.07.2018 "Mbi miratimin në parim për dhënien me qira të objektit "Shkolla e Fshatit Katund i Ri" (3 kat + papafingo, palestër, terren sportiv dhe dhomë kaldaje) me një sipërfaqe afërsisht prej 6700 m² ndodhur në Z.K. 2124 Nj. A. Bradashesh, Elbasan pa i ndryshuar destinacionin në funksionit realizimit të programeve mësimore në zbatim të kriterëve të konkurimit si më poshtë:

A - Niveli i investimit:

Për investim nga 1-3 milion lekë	1 - 5 pikë
Për investim nga 3.1- 6 milion lekë	6 - 10 pikë
Për investim nga 6.1- 10 milion lekë	11 -15 pikë
Për investim mbi 10 milion lekë	16 - 25 pikë

B – Kriteri i punësimit:

Deri në 10 punonjës	1 - 5 pikë
Nga 11-20 punonjës	6 - 10 pikë
Nga 21-30 punonjës	11 - 15 pikë
Mbi 30 punonjës	16 - 25 pikë

C - Oferta e qirasë mujore:

Oferta minimale është 75 lekë/m ² sipërfaqe ndërtimin	5 pikë
Oferta minimale e truallit të lirë funksional të objekti është 20% (njëzet për qind) e tarifës dysHEME të detyrimit mujor të përcaktuar për sipërfaqen e ndërtimit.	
Për vlera mbi ofertën minimale	10 pikë

D – Afati i dhënies me qira:

20 vjet.

Të gjithë të interesuarit janë të lutur të paraqesin brenda datës 15.08.2018 ora 09:00. dokumentacionin si më poshte:

a) Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore, ku të deklarohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore, si dhe treguesit e konkurrimit, të parashikuar sipas planit të biznesit.

b) Planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:

- Identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen;
- Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;
- Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij;
- Niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.

Nëse kërkesa e subjektit është për një afat kohor mbi 5 (pesë) vjet, plani i biznesit të jetë i përshkruar hollësisht, me të dhënat për 5 (pesë) vitet e para të aktivitetit dhe parashikimin për periudhën tjetër.

c) Deklaratat në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:

- Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkues;
- Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;
- Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë në objekte, pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt, të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;
- Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.

Hapja e ofertave do të bëhet në datën 15.08.2018, ora 11:00.

Ofertat dorëzohen me zarf të mbyllur në zyrën e Protokollit pranë Bashkisë Elbasan.